

**THIRRJE PËR ESE PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME****Balkan Debate Academy: Debating towards Cooperation**

Projekti Balkan Debate Academy: Debating towards Cooperation hap thirrje për ese për nxënësit e shkollave të mesme nga Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Kosova\*. Esetë më të mira të cilat do të zgjidhen do të fitojnë bursë të plotë për pjesëmarrje në Akademinë Ballkanike të Debatit në Shkup. Projektin e realizon Forumi Arsimor Rinor në bashkëpunim me Komunikimin e Hapur nga Serbia, Qendrën për Dialog Kulturor nga Bosnja dhe Hercegovina dhe Qendrën për Debat nga Kosova, me mbështetje të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RIKO).

Nxënësit që do të aplikojnë në thirrjen mund të zgjedhin një nga dy temat për ese:

1. Vallë e përkufizon e kaluara të ardhmen tonë?
2. Progresi fillon me dialog.

Thirrja për ese është e hapur deri më 14 tetor 2018, nxënësit e shkollave të mesme të interesuar duhet në mënyrë elektronike t'i dërgojnë esetë e tyre në [debateacademy@mof.org.mk](mailto:debateacademy@mof.org.mk), të shënuara si "Aplikim për Akademinë Ballkanike të Debatit".

Kushtet për pjesëmarrje:

- Thirrja është e hapur për nxënësit e shkollave të mesme të moshës prej 14 deri në 18 vjeç nga Maqedonia, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova,
- Esetë duhet të shkruhen në gjuhën angleze, me gjatësi prej të paktën 800 dhe maksimum 1200 fjalë, të shkruara me fond Times New Roman 12;
- Aplikacioni për pjesëmarrje duhet të përmbajë ese të shkruara në Microsoft Office Word m[ shtojcë të e - mailit, së bashku me emër, mbiemër, vendbanimin, e - mail adresën, telefonin për kontakt dhe fotografi të autorit ( të cilat do të publikohen së bashku me esenë).

Pas përfundimit të thirrjes, komisioni i përbërë nga tre anëtarë do të zgjedhë 9 esetë më të mira nga çdo vend. Fituesit e konkursit do të fitojnë burë të plotë për pjesëmarrje në Akademinë Ndërkombëtare Balkan Debate Academy: Debating towards Cooperation. Akademia e cila do të mbahet nga 30 tetor deri më 4 nëntor në Shkup, do tu mundësojë nxënësve të shkollave të mesme të marrin pjesë në kurs të avancuar për debat dhe të fitojnë shkathtësi teorike dhe praktike në fushën e argumentimit, mendimit kritik dhe diskutimit publik.

Debatet e avancuara do të përfshijnë trajnim në fushën e debatit garues, diskutimit publik dhe shprehjes së argumentuar nga trajnues ndërkombëtarë dhe nacional, duke përfunduar me turnir debatues, ku pjesëmarrësit do të kenë mundësi të zbatojnë shkathtësitë e reja të cilat do t'i fitojnë.

Pjesëmarrësit në Akademi, do të fitojnë certifikatë për trajnim të suksesshëm për debat dhe diskutim publik. Për më tepër informacione për këtë thirrje për ese, mund të na shkruani në [debateacademy@mof.org.mk](mailto:debateacademy@mof.org.mk) ose të paraqiteni në: 02 3139 692.



*This project is supported by the Regional Youth Cooperation Office – RYCO. Its content is the sole responsibility of Youth Educational Forum and its partners and does not necessarily present the views of RYCO.*

*\*This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSCR 1244 and the ICJ Opinion on the Kosovo Declaration of Independence.*